




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot. Br Prot. Prot No
<u>DPK</u>	<u>03-02/320/18</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Date Datum Date
<u>02</u>	<u>02-02-2018</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.02.2018, mori:



V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2515/17, për z. Fatmir Hoxha, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, për shkak se i njëjti tashmë nuk gjendet në mesin e zyrtarëve të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Fatmir Hoxha, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, për shkak se ai është dyshuar se ushtron edhe një funksion menaxhues në një biznes privat.

Prandaj, zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Hoxha e ka njoftuar Agjencinë se nuk është duke e ushtruar funksionin Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, prandaj ai është delaruar se do të sjellë në AKK edhe formularin e deklarimit të pasurisë pas përfundimit të funksionit.

Ndërkohë, z. Hoxha ka sjellë në Agjenci formularin e Agjencisë pas përfundimit të detyrës, me të cilin dëshmohet se ai tashmë nuk ushtron funksion publik i cili hynë në mesin e zyrtarëve të lartë publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

